

DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i nënshkruari Blerim Pruthi i lindur me 19.07.1980, në Gjakovë, numri personal 1003341018, solemnisht deklaroj se me shkrimin e kësaj Deklarate betohem se i plotësoj kushtet për emërim në pozitën e Auditorit të Brendshëm.

Plotësoj kushtet e kualifikimit sipas Nenit 17.1. (11) plotësoj kriteret e pavarësisë sipas nenit

17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (I). Kam përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë, siç është përcaktuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr.03/L-087, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 dhe me Ligjin nr.05/L-009).

Domethënë:

17.1 Një person ka të drejtë të shërbejë si drejtor vetëm nëse i plotëson të gjitha kushtet me poshtë si dhe kushtet për pavarësi dhe përshtatshmëri profesionale të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 nenit 17 të këtij ligji:

a) nuk është dënuar ose vendosur nga një gjykatë kompetente, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë tjetër në bazë të ankesës, se ka kryer veprë penale ose civile që përfshin përgënjeshttrim, prezantim të rrejshëm, korrupsion, vjedhje, pastrim të parave, përvetësim, keqpërdorim apo ndarje të rrejshëm të fondeve, ka qenë i përfshirë në mitosje apo ryshfet sipas ligjeve apo rregulloreve në fuqi në Kosovë apo ndonjë vend tjetër, apo sipas traktateve ose konventave ndërkombëtare:

b) nuk është vendosur nga një gjykatë ose organ apo organizatë përgjegjëse për zbatimin e kodit etik apo standardeve të sjelljes profesionale, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër në bazë të ankesës (i) se është angazhuar në sjellje jo-profesionale, (ii) se ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, (iii) se ka keqpërvetësuar apo ka keqpërdorur paratë apo burimet publike, (iv) se ka keqpërdorur apo keqpërvetësuar informatat (të dhënat) e fituara gjatë shërbimit si zyrtar publik apo shërbyes civil, ose (v) se ka keqpërdorur postin publik ose postin në shërbimin civil për përfitime personale ose për përfitime apo përparësi të një të afërmi ose të njohuri; apo;

c) nuk ka bërë përgënjeshtime material nën çfarëdo dëshmie nën betim apo betimi tjetër, ose dokumenti të vulosur apo noterizuar; dhe

d) nuk është shpallur i falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara;

17.2 Një person nuk konsiderohet i pavarur dhe nuk kualifikohet për zgjedhje si drejtor në një NP nëse:

d) është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie material afariste me NP-në përkatëse ose cilado nga filialet e saj

f) mban drejtorësi të ndërsjellë ose ka lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjerë të NP-së përkatëse përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe;

h) ka shërbyer në Bordin e Drejtorëve të NP-së përkatëse më shumë se nëntë (9) vite nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj;

j) është ose (i) punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionari, ose ka një Interes Financiar në, një shoqëri tregtare të palistuar dhe që konkurren me Ndërmarrjen, ose (ii) menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy përqind (2%) të të drejtave të votimit) i, ose ka një interes të konsiderueshëm Financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare të listuar që konkurrojnë me Ndërmarrjen: dhe k) është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;

l) ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në menyrë rutinore, me besnikëri, në menyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij fiduciare ndaj Aksionarëve dhe NP-së. Çdo përgënjeshttrim material-qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca - ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e cekur më sipër do rezultojë me diskualifikim të menjëhershëm dhe nëse është e aplikueshme, largimin e personit nga KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A.

Nënshkrimi:

Data: 20/07/2022

Vërejtje: Kjo deklaratë dhe ky Betim nuk konstituon asnjë lloj marrëdhënie të çfarëdollojshme ndërmjet kandidatit dhe NP KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A., dhe si e tillë trajtohet si e veçantë dhe në raport me çfarëdo kontesti apo kundërthënie.